



Republika e Kosovës/
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova -
Kosovo Agency of Statistics

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Anketa e Mbeturinave Industriale 2014





Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova -
Kosovo Agency of Statistics

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Anketa e Mbeturinave Industriale 2014



Botuesi: Agjencia e Statistikave së Kosovës (ASK)

Data e botimit: Dhjetor 2015

© : Agjencia e Statistikave së Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata të shumta janë në dispozicion në internet, ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së në internet:

<http://ask.rks-gov.net/>

Parathënie

Ky është publikimi i katër me radhë që Agjencia e Statistikave të Kosovës ka organizuar dhe realizuar për statistikave të mbeturinave nga industria sipas NACE Rev.2.

Objektivi kryesor i këtij studimi është që të ofrojë të dhëna për mbeturinat nga sektor të ndryshëm të industrisë në Kosovë. Rezultatet e paraqitura në këtë botim janë burim i rëndësishëm statistikorë për mbeturinat e gjeneruara dhe përpunuara nga sektorët e industrisë siç janë: B, C, D, E, F, G-U.

Instrumentet statistikore të përdorura gjatë këtij hulumtimi janë në përputhje me Rregulloren (EC) Nr 2150/2002 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 25 Nëntorit 2002 mbi statistikave të mbeturinave, Listës Evropiane të Mbeturinave dhe Ligjit për Mbeturina në Kosovë, (Nr. 02 / L-30).

Falënderimet i dedikohen ekspertit nga GOPA Juergen Gonser (ARGUS GmbH, Berlin) për mbështetje profesionale.

Ky publikim u përgatit nga DSB&M, përkatësisht nga Divizioni i Statistikave të Mjedisit:

Bajrush Qevani, Drejtor, Haki Kurti, Shef i Divizioni,

Flutura Shosholli, Zyrtare, Liridona Osmani, Zyrtare.

Sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet për këtë publikim janë të mirëseardhura dhe mund të dërgohen me e-mail: agriculture@rks-gov.net

Dhjetor 2015

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së
z. Isa Krasniqi

Shkurtesat dhe Simbolet

BE Bashkimi Evropian

ASK Agjencia e Statistikave të Kosovës

NACE Rev.2 Klasifikimi i Aktiviteteve Ekonomike

EWStat . European Waste Clasification for Statistic (Version 4)

LoW Lista e Mbeturinave

DSBM Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

Simbolet

T Ton

% Përqindje

: Nuk ka të dhëna të disponueshme

P ë r m b a j t a

	Faqe
Informacione të përgjithshme	5
Objektivat e anketës	5
Metodologjia.....	6
Mbledhja e të dhënave.....	7
Definicionet.....	7
Rezultatet.....	8
Aneks 1.Pyetëtori	12

Informacione të përgjithshme

Anketa e mbeturinave industriale në Kosovë u realizua sipas NACE Rev.2, i cili njëkohësisht është dhe klasifikim statistikor i aktiviteteve ekonomike. Mbeturinat janë klasifikuar si të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, sipas listës së mbeturinave.

Njësi raportuese janë të gjitha kompanitë me 10 e më shumë punëtorë. Kompanitë e përfshira janë klasifikuar nga NACE Rev.2 në sektorët e aktiviteteve vijuese:

1. *B- Xehetari dhe guroret*
2. *C- Prodhimit*
3. *D- Furnizimi me energji elektrike, gaz avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar*
4. *E- Furnizimi me ujë, kanalizim, menaxhim i mbeturinave dhe rregullim toke*
5. *F- Ndërtimtaria*
6. *G-U - Sektorët e shërbimeve*

1. Objektivat e anketës

Qëllimi i anketës së mbeturinave industriale 2014 ka qenë që të siguroj të dhënat për mbeturinat e gjeneruara nga industria. Të dhënat u mbledhën për dy kategori: Mbeturina të gjeneruara dhe mbeturina të përpunuara.

Objektiv i AMI 2014 ka qenë realizimi i anketimit për gjenerimin e mbeturinave nga industria, për grupet NACE Rev 2.

Gjithashtu objektivi i anketës ka qenë, që anketimi të realizohet në përputhje me kërkesat në nivel vendi dhe njëkohësisht ato të jenë në harmoni me rekomandimet ndërkombëtare.

1.2 Metodologjia

1.2.1 Korniza e anketës

Të gjitha procedurat e hulumtimit dhe përgatitja e instrumenteve statistikore janë finalizuar gjatë muajit Prill/Maj 2015.

Mbledhja e të dhënave nga terreni është kryer gjatë muajit qershor 2015, ndërsa intervistimi është realizuar sipas metodës "ballë për ballë".

Plani i punës ka pasur këto faza:

1. Fazën përgatitore
2. Mbledhjes së të dhënave
3. Përpunimi i të dhënave
4. Analizën e të dhënave
5. Tabelimin dhe
6. Botimi/publikimi

Gjatë fazës përgatitore janë kryer këto aktivitete: mostra e anketës, pyetësi, variablat, plani kohor, udhëzuesi për intervistuesit, trajnimi i intervistuesve dhe ndërtimi i bazës së të dhënave. Mostra është përgatitur sipas regjistrit statistikor për biznes.

Trajnimi është mbajtur një ditë në ASK, për të gjithë anketuesit të cilët kanë qenë të angazhuar në mbledhjen e të dhënave nga terreni.

Mostra e AMI 2014 është përberë prej 878 bizneseve. Numri i përgjithshëm i bizneseve të cilat janë përgjigjur në anketë ka qenë 592. Njësi raportuese në anketë kanë qenë kompanitë me 10 e më shumë punëtorë.

1.2.2 Mbledhja e të dhënave

Mbledhja e të dhënave ka përfunduar nëpërmjet intervistimit ballë për ballë, me menaxherët e kompanive industriale që veprojnë në rajonin përkatës, bazuar në pyetësorë (Shtojca 1).

1.2.3 Përpunimi, analiza dhe tabelimi i të dhënave

Të gjithë pyetësorët janë kontrolluar për kontrollin e cilësisë në ASK, gjithashtu përpunimi, analiza dhe tabelimi janë përgatitur nga ekspertët e Divizionit të Statistikave të Mjedisit.

2. Definicionet

Mbeturinat industriale: mbeturinat e gjeneruara nga sektori i industrisë.

Mbeturinat e rrezikshme: mbetje e cila sjell dëm dhe rrezik për shoqërinë, e cila tregon rrezik domethënës për shëndetin njerëzor apo mjedisin kur nuk menaxhohet në mënyrë adekuate. Mbeturinat e rrezikshme janë të ndezshme, gërryese, reaktive ose toksike. Mbeturinat e rrezikshme - janë mbeturinat të cilat kanë të paktën një nga karakteristikat e mëposhtme:

- shpërthyes, oksidante, djegëse, irrituese, e keqe, toksike, kancerogjene, gërryese, infektuese, teratogjerike, mutagjene, emetuese, gazra toksike në kontakt me ujin, ajrin ose një acid, ka të ngjarë të prodhojë substanca tjera të rrezikshme, dhe eko toksike

3. REZULTATET E ANKETËS SË MBETURINAVE NGA INDUSTRIJA 2014

Rezultatet nga AMI 2014, tregojnë se nga industria, përkatësisht nga sektorët e aktiviteteve vijuese;

1. B- Xehetari dhe guroret,
2. C- Prodhimit,
3. D-Furnizimi me energji elektrike, gaz avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar,
4. E-Furnizimi me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës,
5. F- Ndërtimtari,
6. G-U Sektorët e shërbimeve.

Gjithsej janë gjeneruar 286,152 ton mbeturina prej tyre 495 ton mbeturina të rrezikshme.

Tabela 3.1: Gjithsej sasia e mbeturinave të gjeneruara nga sektorët e industrisë

Lloji i industrisë	Gjithsej mbeturina të gjeneruara	Mbeturina të rrezikshme (nga gjithsej)	Gjithsej mbeturina të përpunuara ¹
	Ton		
Gjithsej B, C, D, E, F, G-U	286,152	495	286,152

Tabela 3.1. tregon gjithsej sasinë e mbeturinave të gjeneruara. Gjithashtu kjo tabelë tregon sasinë e mbeturinave të rrezikshme dhe të përpunuara në vitin 2014. Gjithsej sasia e mbeturinave të rrezikshme për vitin 2014 ka qene 495 ton.

¹Përpunim i mbeturinave – operim, ku rezultati kryesor i të cilit është vënia në shërbim e mbeturinave për qëllime të dobishme, duke zëvendësuar materialet tjera të cilat përndryshe do të duhej përdorur për të plotësuar një funksion të caktuar, apo përgatitja e mbeturinës për të plotësuar ato funksione në ndonjë impiant apo ekonominë e gjerë. Shtojca II (Lista R – lista e operimeve potenciale).

Tabela 3.2 Mbeturina të gjeneruara NACE Rev. 2

NACE Rev. 2		Mbeturina të gjeneruara
Seksioni	Ndarjet	Ton
B	05-09	201,245
CA	10-12	6,500
CB	13-15	147
CC	16-18	472
CD	19	:
CE	20	102
CF	21	:
CG	22-23	64,688
CH	24-25	662
CI	26	:
CJ	27	29
CK	28	10
CL	29-30	23
CM	31-33	490
D	35	310
E	36-39	1,906
F	41-43	4,517
G-U	45-99	5,051
Gjithsej		286,152

Të dhënat në tabelën 3.2. tregojnë se sasia më e madhe e mbeturinave është gjeneruar në seksionin B (xehetari dhe guroret), gjithsej 201,245 ton. Ndërsa sasia më e vogël e mbeturinave të gjeneruara për vitin 2014, ka qenë në seksionin CK, me vetëm 10 ton.

Rezultatet nga anketa tregojnë se, sasia më e madhe e mbeturinave të gjeneruar është në sektorin e xehetarisë dhe gurëthyes 201, 245 ton ose 73%.

Tabela 3.3: Sasia e mbeturinave të gjeneruara dhe mbeturinave të rrezikshme, në vitin 2014.

Lloji i industrisë	Mbeturina të gjeneruara	Mbeturina të rrezikshme
	Ton	
B Xehëtari dhe gurëthyes	201,245	1
C Prodhimi i produkteve ushqimore, pijeve dhe produkteve të duhanit	73,123	461
D Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	310	:
E Furnizimi me ujë, kanalizim, menaxhimi i mbeturinave, rregullim toke	1,906	:
F Ndërtimtaria	4,517	10
G-U Sektorët e shërbimeve	5,051	23
Gjithsej	286,152	495

Grafiku 1: Struktura e mbeturinave me sasinë me të madhe të gjeneruar sipas llojit të industrisë.

Struktura e mbeturinave të gjeneruara nga sektori B-C, në %




Tabela 3.4:Përpunimi i mbeturinave sipas llojit të industrisë

Seksioni	Nace rev.2.2	Gjithsej mbeturina të gjeneruara	Mbeturina të marrura nga kompanitë tjera për trajtim	Të djegur (përfshirë edhe ato për prodhimin e energjisë)	Mbeturina të përpunuara	Mbeturina të ricikluara	Deponuar	Dërguar diku tjetër	Gjithsej mbeturina të përpunuara
B	05-09	201,245	:	2	116	:	201,037	89.85	201,245
CA	10-12	6,500	:	83	729	2.8	2,437	3,248	6,500
CB	13-15	147	:	12	:	:	21	114	147
CC	16-18	472	75	77	:	:	281	114	472
CE	20	102	:	18	4	3	22.35	54.8	102
CG	22-23	64,688	6.03	133	466	2,274	564	61,251	64,688
CH	24-25	662	:	4.6	10.5	38	19	590	662
CJ	27	29	:	:	10	2.5	6	10.1	29
CK	28	10	:	1.6	2	:	1	5.4	10
CL	29-30	23	:	0.4	:	:	4.3	18.2	23
CM	31-33	490	60	105	2.7	220	136.5	25.5	490
D	35	310	:	25	:	:	0.65	284.5	310
E	36-39	1,906	:	10.6	:	5	1,503	386.9	1,906
F	41-43	4,517	:	792	24.80	8	1,273	2,420	4,517
G-U	45-99	5,051	57	43	3.30	96	2,546	2,362	5,051
Gjithsej		286,152	198	1,308	1,368	2649	209,852	70,975	286,152

Tabela 3.4. Tregon se sasia më e madhe e mbeturinave të deponuara ka qenë nga xehëtaria, gurëthyesit dhe nga sektori i shërbimeve.

Aneks 1 Pyetësoni

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

628.54(496.51) “2014”(084.2)

Anketa e mbeturinave industriale : 2014 / Përgatiten Bajrush Qevani... et al.]. - Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2015. - 19 f. : ilustr. ; 28 cm. - (Seria 2 Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit)

Parathënie / Isa Krasniqi: f. [II]

1. Qevani, Bajrush 2. Kurti, Haki

ISBN 978-9951-22-246-4

Agjencia e Statistikave të Kosovës përshkrim i shkurtër

Agjencia e Statistikave të Kosovës, është institucion profesional, i cili vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe. Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmësëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Misioni i Agjencionit, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

Adresa: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Rr. "Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë

Telefonat: +381 (0) 31 129

Kryeshefi ekzekutiv : +381 (0) 38 200 31 112

Fax: +381 (0) 38 235 033

E-mail: agricultural@rks-gov.net

Ueb-faqe: <http://ask.rks-gov.net/>

ISBN 978-9951-22-246-4



9 789951 222464